



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 346, datë 27.06.2023

**PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË GJYQTARËVE
QË KANË OSE MUND TË KENË DY VLERËSIME, NJË VLERËSIM,
SI DHE TË GJYQTARËVE QË NUK KANË E NUK MUND TË KENË ASNJË
VLERËSIM, PËR EFEKT TË KANDIDIMIT NË PROCEDURAT E LËVIZJEVE
PARALELE NË GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM ELBASAN E LEZHË DHE GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË
SHKALLËS SË PARË TIRANË, TË SHPALLURA ME VENDIMET E KËSHILLIT
TË LARTË GJYQËSOR Nr. 248, 249, 250, 251, 252, 253, 254, 255, 256, 257 DHE 258
DATË 24.05.2023**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a” dhe “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 shkronja “ll”, 43, 84, 85 dhe 171, pika 5 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 61 dhe 86, shkronja “dh” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.263 datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe atë nr. 320 datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, bazuar në Programet e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2021 dhe 2023 dhe në Vendimet nr. 248-258, datë 24.05.2023 “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Lezhë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në total për njëmbëdhjetë pozicione të lira të përhershme, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan e Lezhë dhe Gjykatën Administrative të

Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.248, 249, 250, 251, 252, 253, 254, 255, 256, 257 dhe 258, datë 24.05.2023, sipas Shtojcës I bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan e Lezhë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.248, 249, 250, 251, 252, 253, 254, 255, 256, 257 dhe 258, datë 24.05.2023, sipas Shtojcës II bashkëngjitur këtij vendimi.
3. Miratimin e listës së gjyqtarëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan e Lezhë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.248, 249, 250, 251, 252, 253, 254, 255, 256, 257 dhe 258, datë 24.05.2023, sipas Shtojcës III bashkëngjitur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA I

Lista e gjyqtarëve që kanë 2 (dy) vlerësime:

Asnjë (zero) gjyqtar

Lista e gjyqtarëve që mund të kenë 2 (dy) vlerësime:

1. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.
2. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, pas datës 01.07.2023, gjyqtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje.

SHTOJCA II

Lista e gjyqtarëve që kanë 1 (një) vlerësim:

Asnjë (zero) gjyqtar

Lista e gjyqtarëve që mund të kenë 1 (një) vlerësim:

1. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
2. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.
3. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

SHTOJCA III

Lista e gjyqtarëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim:

1. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë.
2. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.
3. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.
4. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.
5. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
6. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.
7. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
8. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, i transferuar përkohësisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, pas dt.01.07.2023 gjyqtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje.
9. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, e transferuar përkohësisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, pas dt.01.07.2023 gjyqtare e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje.
10. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, aktualisht e komanduar si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë.
11. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, aktualisht e komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.